Dhori Qiriazhi⁷⁷ vë re se një kategori e fjalëve popullore me semantikë dëshirore përbëjnë një rast të veçantë izosemie midis shqipes dhe greqishtes. Pas një shqyrtimi të hollësishëm të lëndës gjuhësore në të dyja gjuhët ai arrin në përfundimin se: “E njëjta semë shprehet nëpërmjet strukturash identike, të ngjashme a të ndryshme”. Më konkretisht, në çiftet i paarrirë-anéφταστος, pikërëpë-πικοβαρεμένος, kemi përputhje të plotë semantiko-morfologjike, në çiftet: (a) ditësosur-κουσοήμερος, (b) rrënjëdalë-ανερρίζωτος, (c) hajeujk-λυκοφαωμένος, e njëjta semë realizohet nëpërmjet strukturash të ndryshme morfologjike, përkatësisht: rend i kundërt i fjalëve (a), kompozitë dëshirore-mbiemër prejfoljor me parashtesë mohuese (b),

⁷⁶ Shembujt në gjuhën shqipe janë marrë nga Fjalori i gjuhës së sotme shqipe 1980 ndërsa për gjuhën greke është përdorur fjalori Γ. Μπαμπινιώτης, Λεξικό της Νέας Ελληνικής Γλώσσας, Β' εκδ. Κέντρο Λεξικολογίας, Αθήνα, 2002, si dhe studimi i S. Trloupa, *Ευχές Εόρκια Κατάρες Εκφράσεις Θυμού*, University Studio Press, Θεσσαλονίκη, 2001.

⁷⁷ Dh. Qiriazhi, «Ndikime të shoqishoqme a zhvillime paralele. Vështrim krahasues në fjalë popullore me semantikë dëshirore të greqishtes dhe të shqipes» *SNGJLKSJH 22/1 UP-FF*

përngjitje-kompozim (c).

Mallkimet, kanë *karakter pasthirmor*, vetëm se nuk janë thirrje të zhveshura. Ato shumë shpesh nisin me tinguj pasthirmash ose me pasthirrma të pastra, të cilat përbëjnë edhe pikëmbështetjen e tyre. Intensiteti emocional shfryn ose shfaqet me mjete gjuhësore të përforcuara siç janë tonaliteti ose ngarkesa kuptimore e disa fjalëve në të cilat përfshihen edhe ato të leksikut bazë popullor.

Një tregues se përse mallkimet dhe urimet studiohen bashkë, është ai se në thelb kemi të bëjmë me dy forma antonimike që i përkasin dy poleve të kundërta të një boshti të vetëm, boshtit të dëshirave të njeriut⁷⁸. Mallkimet kanë karakter negativ ndërsa urimet pozitive. Është fakt se dallimet midis tyre nuk janë thelbësore. Është e natyrshme që te mallkimet, intensiteti i ekspresivitetit arrin kulmin, dëshira mund të jetë asgjësuese, kërkon vdekjen e atij që i dërgohet, kurse tek urimet intensiteti i shprehësisë dhe i dëshirës nuk është i këtij niveli. Ose e thënë ndryshe, karakteri magjik i gjuhës është më shumë intensiv tek mallkimet, ndërsa tek urimet është më i thellë. Tek të parat manifestohet për nga personi të cilit i drejtohet mallkimi (marrësi), ndërsa tek të dytat shndërrohet në lidhje emocionale midis dhënësit dhe marrësit të tyre. Urimet, mund të kombinohen lehtësisht me lutje, falënderime, ironi e ndjenja emocionale të forta si shqetësimi ose frika. Për mallkimet, kombinime të tilla janë më të vështira për tu realizuar.

Një tjetër dallim midis urimeve dhe mallkimeve është se të dytat, duke qenë se përbëjnë akt gjuhësor të së keqes, nuk mund të jenë parandaluese. Mund të provokojnë, e shumta një kundërmallkim, pra një kundërpërgjigje të të mallkuarit me anë të një mallkimi tjetër. Urimi, nga ana tjetër, është akt gjuhësor i së mirës, që mund të kërkojë realizimin e së mirës ose edhe parandalimin e së keqes.

5. *Përshtëndetjet* janë shprehje gjuhësore të drejtpërdrejta që realizohen në çastin e takimit të dy personave, pra përshtëndetja shërben si pikënisje e komunikimit ndërpersonal, përbën aktin e hapjes dhe njëkohësisht të vendosjes së marrëdhënieve midis njerëzve; nëpërmjet saj njeriu shpreh se pajtohet me rregullat më të thjeshta të sjelljes së marrëdhënieve ndërvetjake. Përshtëndetja rregullon marrëdhëniet shoqërore midis folësve, e bën më të qëndrueshëm komunikimin midis tyre. Mungesa e përshtëndetjeve apo edhe e urimeve, pavarësisht karakterit stereotip të tyre, do të krijonte keqkuptime në marrëdhëniet midis anëtarëve të një bashkësie gjuhësore⁷⁹. Si shprehje popullore universale që ekzistojnë në të gjitha gjuhët, për pasojë dhe në shqipe e në greqishte, ato pak a shumë marrin trajtën e një urimi i cili shkakton edhe një reagim që shoqërohet me një urim të dytë nga ana e marrësit. Përshtëndetjet mund të jenë shprehje gjuhësore të mirëpërpunuara, por mund të jenë edhe krejtësisht standarde dhe abstrakte, gjë që tregon se më i rëndësishëm është ushtrimi sesa përmbajtja e tyre. Në të vërtetë përshtëndetja është akt gjuhësor i njohjes dhe mënyrat e shprehjes së saj përbëjnë realizime të

⁷⁸ Σ. Σκαρτσής, *Μικρομορφές της Λαϊκής Λογοτεχνίας*. Ελληνικά γράμματα, Αθήνα, 1999, fq. 17-35

⁷⁹ Xh. Shkurtaç, *Onomastikë dhe Etnolinguistikë*. SHBLU, Tiranë, 2001, fq.115

ndërgjegjësimit të kësaj njohjeje dhe të shfaqjes së saj me terma socialë parësorë. Shfaqja si një e tërë e përshëndetjes vë në lëvizje të gjithë mekanizmat psiko-fiziologjikë që bashkekzistojnë dhe veprojnë me tiparin shoqëror dhe kontaktet njerëzore. Është reagimi i parë që nga vënia e kontaktit. Dhe përbën pikërisht njohjen dhe shprehjen e ndërgjegjshme të kontaktit si parësor ashtu edhe abstrakt e metaforik. Ndjenja e kontaktit shprehet me kontaktin fizik (p.sh. dhënia e dorës ose përqaftimi), me gjeste ose lëvizje dhe me shprehje gjuhësore të drejtpërdrejta e standarde. Paraqesin një shkallë të lartë shumëllojshmërie e cila është e lidhur me statusin e individit apo edhe me situatën e komunikimit në përgjithësi.

Mund të ekzistojë një lloj uniteti, por edhe mospërputhje midis elementëve të përshëndetjes p.sh. midis gjendjes së vërtetë shpirtërore dhe shprehjes gjuhësore. Natyrisht që përshëndetjet mund të jenë miqësore por edhe armiqësore, mund të shprehen por mund të jenë edhe të heshtura. Madje, kanë mundësinë të mbartin ngarkesa emocionale. Interes të veçantë paraqesin përshëndetjet ose të falat që i dërgojmë një njeriu që nuk është prezent me ne në çastin e ligjërit. Këto përvijohen në shenja gjuhësore ose në fjalë që kanë për synim vendosjen e kontaktit nëpërmjet një personi të tretë. Është akoma më interesant fakti që ky person i tretë nuk ka ndonjë rëndësi të madhe, as nuk e zgjidh problemin e vazhdimësisë së kontaktit midis personave që komunikojnë midis tyre.

Përgjithësisht, përshëndetjet shkëmbehen më shumë mes personave që takohen me njëri-tjetrin ndërsa në përshëndetjet e ndarjes ose të largimit mbizotërom elementi i urimit: *çoi të fala* = *δώσε χαιρετίσματα*, *mirëdita* = *καλημέρα*, *mirëmbrema*=*καλησπέρα*, *mirë se erdhe/-ët*=*καλώς ήρθες/-ατε*, *mirë se urdhërove/-uat* = *καλώς όρισες/-ατε*, *mirë të gjetça*=*καλώς να σ'εύρω*, *mirë se ju gjeta* = *καλώς σας βρήκα*, *natën e mirë* = *καληνύχτα*, *rrugë të mbarë*=*καλό ταξίδι/καλό δρόμο να 'χεις*, *u gdhifshi mirë*=*καλό ζημέρωμα/καλά χαράματα*

Si përfundim, shprehjet popullore në shqipe e në greqishte, dhe më konkretisht, urimet, mallkimet dhe përshëndetjet, kanë veçori semantike, ndërtime, leksikore, intonacionore etj., por kanë dhe shumë elemente të përbashkëta që lidhen me të gjitha këto rrafshe. Paralelet apo përputhjet nuk janë rastësore, ato shpesh shfaqen si një produkt etno-linguistik shumë shekullor, që lidhet drejtpërdrejt me kontaktet mijëravjeçare ndërmjet dy popujve, atij shqiptar dhe atij grek.

BIBLIOGRAFIA

1. Βέικου, Χ. 1998. *Κακό Μάτι. Η κοινωνική κατασκευή της οπτικής επικοινωνίας*. Αθήνα: Ελληνικά Γράμματα
2. FGJSSH <http://www.fjalori.shkenca.org>
3. Χριστίδης, Α.Φ. 1997. *Η μαγική χρήση της γλώσσας*. Αθήνα: Ιστός,
4. Κυριακίδης Στ. Π. 1965. *Ελληνική Λαογραφία, Μέρος Α΄. Μνημεία του λόγου.αρ.8.*Αθήνα: Ακαδημία Αθηνών
5. Λουκάτος, Δ. Σ. 1985. *Εισαγωγή στην Ελληνική Λαογραφία*. Αθήνα: MIET
6. Μπαμπινιώτης, Γ. 2002. *Λεξικό της Νέας Ελληνικής Γλώσσας, Β΄ εκδ.* Αθήνα: Κέντρο Λεξικολογίας
7. Qiriazhi, Dh. «Ndikime të shoqishoqme a zhvillime paralele. Vështrim krahasues në fjalë popullore me semantikë dëshirore të greqishtes dhe të shqipës» *SNGJLKSH 22/1 UP-FF*
8. Σκαρτσής, Σ. 1999. *Μικρομορφές της Λαϊκής Λογοτεχνίας*. Αθήνα: Ελληνικά γράμματα
9. Shkurtaj, Xh. 2001 *Onomastikë dhe Etnolinguistikë*. Tiranë: SHBLU
10. Τρλουρα, S. 2001. *Ευχές Ξόρκια Κατάρεις Εκφράσεις Θυμού*. Θεσσαλονίκη: University Studio Press

DR. ISIDA FOÇI (METAJ)
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
UNIVERSITETI I TIRANËS
isida.metaj@unitir.edu.al

PËRKTHIMI DHE PËRSHTATJA E TERMINOLOGJISË JURIDIKE

ABSTRAKT

Në këtë kumtesë do të paraqesim disa sfida dhe vështirësi të përkthimit të terminologjisë juridike nga gjuha greke në gjuhën shqipe. Termat që hasim gjatë përkthimit të një çështjeje gjyqësore, të vendimeve të ndryshme gjyqësore apo dokumente e vërtetime që kanë lidhje me gjykatat e shkallëve të ndryshme. Përkthimi i tyre ka raste që mund të jepet me një fjalë, por në shumicën e rasteve ky përkthim vështirësohet pasi gjuha greke është mjaft komplekse, ka mjaft terma nga varianti katharevusa i gjuhës dhe sistemi gjyqësor nuk është i njëjtë. Kjo kumtesë është pikënisja e përballjes së këtyre problematika, të cilat duam t'i konkludojmë në të ardhmen me një fjalorth terminologjik dygjuhësh greqisht – shqip.

Fjalë kyçe: *përkthim, terma, sistem gjyqësor, sfida, juridik.*

Përkthimi juridik, ndoshta më shumë se çdo shërbim gjuhësor, është një detyrë komplekse që kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të ngushtë me përdoruesin e përkthimit. Idealisht, zhvillohet një marrëdhënie afatgjatë e cila bazohet në një përshkrim dhe analizë të detajuar të kërkesave dhe udhëhiqet nga besimi reciprok. Sidomos në pjesën e analizës së kërkesave, udhëzimet nga klienti luajnë një rol të rëndësishëm në vetë përkthimin, verifikimin e burimeve, terminologjinë, madje edhe renditjen e tekstit origjinal me përkthimin e certifikuar.

Në përkthimin juridik, një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet përkthyesi është historiku i teksteve, në rastin e teksteve që janë shkruar shumë vite më parë, në shoqëri dhe kultura me karakteristika krejtësisht të ndryshme. Historiku në përkthimin juridik ka të bëjë edhe me Greqinë, për një tjetër veçori të saj. Si

pasojë e çështjes gjuhësore, tekstet juridike shpesh shfaqin sintaksë të vështirë dhe komplekse, forma të katharevusës dhe në përgjithësi ligjëratë të ngjeshur.

Një sfidë tjetër në lidhje me përkthimin e teksteve juridike janë sistemet e ndryshme ligjore dhe gjyqësore të çdo vendi. Për shembull, përkthimi i termave “παισματοδικείο” dhe “ειρηνοδικείο” është veçanërisht e vështirë për përkthyesin anglez, sepse nuk ka një nivel përkatës në sistemin ligjor anglez. Prandaj, termi “konsiderim” është i vështirë për t’u përkthyer në shqip, sepse në sistemin gjyqësor në Shqipëri nuk ekziston shkalla përkatëse. Respektivisht termi “αντιπαροχή” është vështirë për t’u transmetuar, pasi nuk ekziston si koncept në legjisllacionin e huaj.

Përkthyesit duhet të kuptojnë në thelb çështjeve ligjore, të jenë familjarë me terminologjinë juridike dhe të përkthejnë duke ndjekur procedurat e standardit ndërkombëtar ISO 20771:2020.

Çështje që lidhen me përkthimet juridike

Gjatë përkthimit të dokumenteve juridike duhet të merren parasysh çështjet e mëposhtme:

- Fusha e së drejtës: Përkthyesi i mirë i terminologjisë juridike e di se edhe brenda fushës juridike ka fusha krejtësisht të dallueshme të së drejtës që kërkojnë teknika specifike përkthimi. Për shembull, një kontratë nuk ngjason fare me një testament.
- Konceptet ligjore: Një përkthyes i mirë i terminologjisë juridike duhet të hulumtojë dhe të konstatojë përmbajtjen e koncepteve juridike që përmban dokumenti origjinali nga dokumenti i përkthyer, sepse mund të mos ketë as një koncept përkatës në gjuhën e synuar ose në sistemin ligjor të cilit i drejtohet produkti i tyre.
- Sistemi juridik i vendit përkatës: Një përkthyes i mirë i terminologjisë juridike e di se përkthimet juridike shpesh kërkojnë përdorimin e terminologjisë që lidhet me sisteme të ndryshme juridike. Ai gjithashtu duhet të jetë i vetëdijshëm se në çdo vend përdoret terminologji e ndryshme juridike (në varësi të sistemit të zbatueshëm të rregullave ligjore), e cila shpesh është mjaft e ndryshme nga terminologjia përkatëse në një vend tjetër ku flitet e njëjta gjuhë.
- Përdorimi ligjor: Një përkthyes i mirë i terminologjisë juridike kupton përdorimin e synuar të përkthimit, i cili ndikon në qasjen e tyre po aq sa edhe vetë teksti. Terminologjia, frazeologjia, sintaksa, niveli i stilit dhe shumë parametra të tjerë varen nga qëllimi i përdorimit të përkthimit (p.sh. është vetëm për informacion, dispozita detyruese të kontratës apo duhet të paraqitet në gjykatë si provë?).

Gjatë përkthimit të një teksti në fushën e së drejtës, përkthyesi duhet të ketë parasysh sa vijon. Sistemi ligjor nga teksti burimor është i strukturuar në një mënyrë që i përshtatet kulturës dhe kjo reflektohet në gjuhën juridike, në mënyrë të ngjashme, teksti i synuar duhet të lexohet nga dikush i njohur me sistemin tjetër ligjor (i cili korrespondon me juridiksionin për të cilin është përgatitur teksti i synuar) dhe gjuhën e tij. Shumica e formave të shkrimit juridik, dhe kontratave në veçanti, kërkojnë të vendosin të drejta dhe detyrime të përcaktuara qartë për individë të caktuar. **Është e nevojshme të sigurohet një korrespondencë e saktë me këto të drejta dhe detyrime në tekstin burimor dhe në përkthim.** Përkthimi juridik mund të përfshijë gjithashtu, certifikatat e njësimin me origjinalin, deklaratat e dëshmitarëve, depozitimet, kreditet, testamentet, aktet e themelimit, dokumentet gjyqësore, dokumentet e imigracionit, titujt e pronësisë dhe në disa raste prania e përkthyesit në gjykatë.

Përveç boshllëqeve terminologjike ose boshllëqeve leksikore, përkthyesi mund të fokusohet në aspektet e mëposhtme. Kontratat tekstuale në gjuhën burimore janë shpesh specifike për kulturën dhe mund të mos korrespondojnë me kontratat në gjuhën e synuar (shih p.sh. Nielsen 2010). Strukturat gjuhësore që gjenden shpesh në gjuhën burimore mund të kenë struktura drejtpërdrejt ekuivalente në gjuhën e synuar. Prandaj, përkthyesi duhet të udhëhiqet nga disa standarde të ekuivalencës gjuhësore, sociale dhe kulturore midis gjuhës së përdorur në tekstin burimor për të prodhuar një tekst të synuar në gjuhën e synuar. Këto standarde korrespondojnë me një sërë parimesh të ndryshme të përcaktuara si qasje të ndryshme ndaj përkthimit në teorinë e përkthimit. Secili prej standardeve imponon një prioritet të caktuar midis elementeve të gjuhës burimore që duhet të ruhen në gjuhën e synuar. Për shembull, duke ndjekur qasjen funksionale, përkthyesit përpiqen të gjejnë struktura në gjuhën e synuar me të njëjtat funksione si në gjuhën burimore, në mënyrë që funksionaliteti i një pasazhi teksti në gjuhën burimore të vlerësohet më shumë, të themi, sesa kuptimi i fjalët specifike në gjuhën burimore dhe renditjen në të cilën ato shfaqen aty.

Qasjet e ndryshme ndaj përkthimit nuk duhet të ngatërrohen me qasje të ndryshme ndaj teorisë së përkthimit. Të parat janë standardet e përdorura nga përkthyesit në tregtinë e tyre, ndërsa të dytat janë thjesht paradigma të ndryshme të përdorura në zhvillimin e teorisë së përkthimit.

Ekziston një konfuzion midis emrave të disa standardeve të përkthimit të përdorura në praktikën ligjore. Jo shumë avokatë dhe gjyqtarë janë të njohur me terminologjinë e përdorur në teorinë e përkthimit dhe shpesh kërkojnë përkthyes dhe përkthyes të gjykatës që t'u japin atyre një përkthim të mirëfilltë. Ata shpesh e gjykojnë këtë term si një standard të qartë të cilësisë që ata dëshirojnë në tekstin e synuar. Megjithatë, kjo zakonisht nuk do të thotë se ato ofrojnë përkthim fjalë për fjalë në kuptimin e standardit të përkthimit në teorinë e përkthimit, me të cilin ata nuk janë të njohur. Përdorimi i këtij termi nga ana e tyre bazohet në një

keqkuptim jospesifik se një përkthim i saktë arrihet vetëm kur fjalët “korrekte” të gjuhës së synuar zëvendësojnë fjalët përkatëse të tekstit burimor. Në fakt, gjithçka që ata duan është të kenë një përkthim besnik dhe të rrjedhshëm të tekstit burimor, pa dyshim që një përkthyes i mirë do ta sigurojë atë. Ata nuk e kuptojnë se përkthimet fjalë për fjalë mund të tingëllojnë si absurditet të plotë në gjuhën e synuar dhe zakonisht nuk e kanë idenë për standardet e ndryshme profesionale të përkthimit. Shumë përkthyes ndoshta do të zgjedhin t’i përmbahen standardit që ata vetë e shohin më të përshtatshëm në një situatë të caktuar, bazuar në përvojën e tyre në vend që të përpiqen të trajnojnë stafin e gjykatës.

Përkthyesit ligjorë shpesh konsultojnë fjalorë juridikë, dhe veçanërisht fjalorë juridikë dygjuhësh. Por duhet pasur shumë kujdes, pasi disa fjalorë ligjorë dygjuhësh janë të cilësisë së dobët dhe përdorimi i tyre mund të çojë në përkthim të gabuar.

BIBLIOGRAFIA

1. *Nielsen, Sandro (1994). The bilingual LSP dictionary. Principles and practice for legal language. Gunter Narr Verlag. ISBN 978-3-8233-4533-6.*
2. *Nielsen, Sandro (2010). «Translational Creativity: Translating Genre Conventions in Statutes». Vertimo Studijos 3: 23–35.*
3. *Šarčević, Susan (2000). «Legal translation and translation theory: a receiver-oriented approach» (PDF). University of Rijeka.*
4. *«All New Theories And Concepts About Translation In New Century».*
5. *Downing, Bruce T. · Bogoslaw, Laurence H. (25 Shkurt 2003). «Effective Patient-Provider Communication Across Language Barriers: A Focus on Methods of Translation».*

AIDA ZOTO
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS GREKE
aida.zoto@unitir.edu.al

PËRKTHYESI NË KOMUNIKIMIN NDËRKULTUROR
ROLI I PEDAGOGUT TË GJUHËVE TË HUAJA

HYRJE

Në kohën kur globalizimi bën që shoqëritë të lidhen ngushtësisht me njëra-tjetrën, komunikimi ndërkulturor dhe bashkëpunimi ndërkombëtar kanë një rëndësi thelbësore për zhvillimin shoqëror dhe personal të individëve⁸⁰. Në këtë kontekst, roli i pedagogut të gjuhëve të huaja si përkthyes ndërkulturor shtrun një sfidë dhe detyrë të rëndësishme në formimin e një brezi të ri të aftë për të funksionuar në një ambient global⁸¹.

Përkthyesi ndërkulturor, i cili është më shumë se një përkthyes i thjeshtë, është një udhëheqës i aftë që i udhëzon studentët në njohjen dhe kuptimin e kontekstit kulturor të gjuhës origjinale dhe atë të gjuhës së përkthyer⁸². Në këtë aspekt, pedagogu i gjuhëve të huaja ka një detyrë të ndërgjegjshme për të promovuar një mjedis mësimor ku studentët mund të zhvillojnë aftësitë e tyre të përkthimit ndërkulturor dhe të kuptojnë thellësinë e lidhjes midis gjuhës dhe kulturës.

Në sferën e arsimit, pedagogu duhet të krijojë strategji mësimore inovative që përfshijnë mësimin nga burime kulturore të ndryshme, përdorimin e materialeve

⁸⁰ Arthur, N., Stewart, J. (2001). Multicultural Counselling in the New Millennium: Introduction to the Special Theme Issue. *Canadian Journal of Counselling/ Revue canadienne de counselling*/2001, Vol. 35:1

⁸¹ Γεράλη-Ρούσου, Ελένη (2006). «Κίνητρα παρώθησης των εκπαιδευτικών», στο: Πρακτικά Συνεδρίου με θέμα: Οι Ξένες Γλώσσες στη δημόσια υποχρεωτική εκπαίδευση: δεδομένα και προοπτικές, Παιδαγωγικό Ινστιτούτο, Αθήνα 31 Μαρτίου-2 Απριλίου 2006

⁸² Darling-Hammond, L. (1998). Teachers and teaching: Testing policy hypotheses from a national commission report. *Educational Researcher*, 27(1)

mësimore të pasura kulturore, dhe organizimin e diskutimeve që inkurajojnë reflektimin mbi dallimet dhe ngjashmëritë kulturore⁸³. Duke i ndihmuar studentët të zhvillojnë njohuri të thella në fushën e përkthimit ndërkulturor, pedagogu ofron një kontribut të pazëvendësueshëm në përgatitjen e tyre për të jetuar dhe punuar në një shoqëri të vazhdueshme në ndryshim dhe globalizim.

Përkthyesi ndërkulturor

Në një botë të globalizuar, ku shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi ndërkulturor janë thelbësore, përkthyesi ndërkulturor shtron sfida të reja dhe krijon një nevojë jetike për ndërgjegjësim dhe përgatitje të thellë në këtë fushë.

Përkthyesi ndërkulturor nuk është thjesht një përkthyes i fjalëve nga një gjuhë në tjetrën, por një udhëheqës i aftë që shkon përtej kufijve të thjeshtë të përkthimit. Ai është një shembull i dinamikës së përshtatjes në situatat e ndryshme kulturore⁸⁴. Një përkthyes ndërkulturor është personi që jo vetëm njeh thellësinë e gjuhës origjinale dhe të asaj të përkthyer, por gjithashtu ka një kuptim të thellë të kontekstit kulturor dhe shoqëror. Një përkthyes i tillë nuk është vetëm një mbajtës i njohurive gjuhësore, por një pasqyrim i thellë i traditave, zakoneve, dhe vlerave të një komuniteti. Për të përfshirë dhe interpretuar me saktësi një kulturë në gjuhën tjetër, përkthyesi ndërkulturor duhet të ketë një njohuri të gjerë të sfidave dhe ndryshimeve kulturore⁸⁵.

Në përgjithësi, përkthyesi ndërkulturor është një përkthyes me një perceptim të pasur të botës dhe një aftësi të shquar për të komunikuar në mënyrë efektive në ndërveprimin e kulturave të ndryshme⁸⁶. Ky proces përfshin jo vetëm një kuptim të thellë të gjuhës, por edhe një ndërgjegjësim të thellë të ngjarjeve dhe kontekstit shoqëror. Pra, ai nuk është thjesht një mesazh-dhënës nga një kulturë në tjetrën. Përkthyesi ndërkulturor është një interpretues i kontekstit kulturor që sjell me vete njohuri të thella dhe aftësi analize për të kuptuar thellësinë e kulturës në fjalë. Ai duhet të bëjë gjithçka që është e mundur për të shmangur humbjen e nuancave kulturore dhe për të përmbushur misionin e tij të ndërtimit të një ure kulturore midis komuniteteve të ndryshme⁸⁷. Përfundimisht, roli i përkthyesit

⁸³ Deardorff, D. K., & Van Gaalen, A. (2012). Outcomes assessment in the internationalization of higher education. *The SAGE handbook of international higher education*

⁸⁴ Ο διαπολιτισμικός μεταφραστής. Υπουργείο Μετανάστευσης και Ασύλου <https://migration.gov.gr/migration-policy/integration/draseis-koinonikis-entaxis-se-ethniko-epipedo/draseis-diapolitismikis-diamesolavisis/>

⁸⁵ García, M. Të Kuptuarit e Sfidave në Përkthimin Ndërkulturor. *Studime Kulturore*, 25(3), 112-130

⁸⁶ Hernandez, A. (2022). “Dallimet Kulturore në Mësimin e Gjuhëve të Huaja.” *Konferenca Ndërkombëtare e Pedagogjisë*, 14(1), 45-58

⁸⁷ Jones, S. (2019). “Roli i Pedagogut në Edukimin Ndërkulturor.” *Revista Përkthyesit*, 14(2), 45-58

ndërkulturor është shumëdimensional dhe përmban një spektrum të gjerë të aftësive dhe njohurive. Ai është jo vetëm një interpretues i fjalëve, por gjithashtu një ambasador i kulturës dhe komunikues i një bote që po ndryshon me shpejtësi⁸⁸.

Roli i pedagogut të gjuhëve të huaja si përkthyes ndërkulturor

Në epokën e globalizmit, ku komunikimi ndërkulturor dhe bashkëpunimi ndërkombëtar po marrin një rëndësi gjithnjë e më të madhe, roli i pedagogut të gjuhëve të huaja si përkthyes ndërkulturor bëhet thelbësor për përgatitjen e studentëve në një mjedis të lidhur ngushtë me realitetin multikulturor. Ky rol shtrihet përtej vetëm thjeshtësisë së transmetimit të njohurive gramatikore dhe leksikore; ai kërkon një qasje të thellë ndaj përfshirjes kulturore dhe kuptimit të thellësive të kontekstit të gjuhës mësohet nga studentët⁸⁹.

Pedagogu i gjuhëve të huaja duhet të shfaqë disa karakteristika që shkojnë përtej funksionit të thjeshtë mësimor. Ai duhet të jetë më shumë se një mësues; ai duhet të jetë një udhëheqës i aftë që jo vetëm frymëzon respekt dhe kuptim ndaj diversitetit kulturor, por gjithashtu nxit aftësitë e studentëve për të përkthyer dhe komunikuar në mënyrë të ndërgjegjshme në një kontekst global⁹⁰.

Një nga aspektet kyçe të këtij roli është inkurajimi i studentëve për të njohur dhe respektuar kontekstin kulturor të gjuhës që po studiojnë. Kjo kërkon përfshirjen e elementeve kulturore në mësim, duke sjellë shembuj konkretë dhe situata që reflektojnë realitetin kulturor. Për shembull, organizimi i diskutimeve dhe aktiviteteve që shqyrtojnë dhe përmirësojnë aftësitë e përkthimit ndërkulturor është një mjet efektiv⁹¹.

Megjithatë, kjo detyrë përballet me sfida të shumta. Një nga sfidat kryesore është ruajtja e një balance të qëndrueshme midis mësimin të gjuhës dhe thellimit të njohurive kulturore. Pedagogu duhet të sigurohet që studentët të marrin njohuri të mjaftueshme në të dyja fushat pa humbur thellësinë e aspektit kulturor. Një tjetër sfidë është trajtimi i dallimeve kulturore me respekt dhe përgjegjësi. Pedagogu duhet të evitojë stereotipet dhe paragjykimet, duke kultivuar një mjedis të ndërgjegjshëm dhe tolerant në klasë⁹².

⁸⁸ Pascua, I. 2003. "Translation and Intercultural Education", *Meta-translation pour les enfants*, 48, pp. 276-284

⁸⁹ Major, E. 2006. Secondary teachers as Cultural Mediators for Language Minority Students. *The Clearing House: A Journal of Educational Strategies, Issues and Ideas*. 80(1), 29-32

⁹⁰ Γκόβαρης, Χ. 2001. Εισαγωγή στην διαπολιτισμική εκπαίδευση, Ατραπός

⁹¹ Μπίκος Κ. (2008). Κοινωνικές σχέσεις στην τάξη εφήβων με πολιτισμικές ιδιαιτερότητες. Στο Παπαναούμ Ζ. (επιστημονική υπεύθυνος), *Διαπολιτισμική Εκπαίδευση και Αγωγή-Οδηγός Επιμόρφωσης*. Θεσσαλονίκη: ΑΠΘ

⁹² Pym, A. (2012) *On Translator Ethics* Trans. Heike Walker. Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins

Nëse pedagogu do të ketë sukses në këtë rol, ai duhet të angazhohet në një trajnim të vazhdueshëm dhe përditësim të njohurive të tij në lidhje me zhvillimet kulturore dhe gjuhësore aktuale. Kjo përfshin përdorimin e burimeve shtesë, librave të fundit, dhe pjesëmarrjen në konferenca dhe seminare ndërkulturore⁹³.

Pra, roli i pedagogut të gjuhëve të huaja si përkthyes ndërkulturore është më shumë se thjesht një detyrë mësuesi. Ai ka një ndikim të thellë në formimin e studentëve dhe aftësitë e tyre për të funksionuar në një mjedis të shumëllojshëm dhe të lidhur ndërkulturore. Përmes një qasjeje të përgjegjshme dhe inovative, pedagogu mund të ndihmojë në përgatitjen e një brezi të ri të studentëve, të cilët jo vetëm do të jenë përkthyes të aftë ndërkulturore, por edhe ndërmjetësues të suksesshëm në një botë gjithnjë e më të lidhur ndërkulturore.

Strategjitë e pedagogut për përmirësimin e përkthimit ndërkulturore

Pedagogu i gjuhëve të huaja ka një rol kyç në formimin e studentëve si përkthyes ndërkulturore, duke u përqendruar në përmirësimin e aftësive të tyre për të kuptuar, përkthyer dhe komunikuar në një kontekst global. Ky rol shtrihet përtej mësimdhënies së thjeshtë të gramatikës dhe leksikut, duke u fokusuar në zhvillimin e një mjedisi që inkurajon respektin ndaj diversitetit dhe kuptimin e thellë të kontekstit kulturor të gjuhës që po mësojnë nxënësit.

Për të ilustruar këtë, mund të përdoren shembuj konkrete dhe strategji efektive:

- ✓ projekte të përkthimit të kulturës: Organizimi i projekteve të përkthimit ku studentët trajtojnë materiale nga kultura të ndryshme. Këto mund të jenë përkthime të teksteve letrare, artikujve të mediave, apo materialeve audiovizuale. Përmes kësaj metode, studentët jo vetëm përmirësojnë aftësitë e tyre përkthimi, por edhe zhvillojnë njohuri më të thella kulturore⁹⁴. Një shembull konkret mund të përfshijë zgjedhjen e një poezie nga një autor i njohur si Konstantinos Kavafis. Studentët mund të zgjedhin një poezi të tillë, si "Ithaka," një nga veprat më të njohura të Kavafisit. Studentët do të angazhohen në një përpjekje përkthimi të fragmenteve të kësaj poezie nga gjuha greke në gjuhën shqipe. Në këtë proces, ata do të përdorin njohuritë e tyre në gjuhësi dhe kulturë për të interpretuar thellësinë e tekstit origjinal dhe për të përshtatur sensin kulturor në përkthimin e tyre. Më pas, studentët do të prezantojnë projektin e tyre duke përfshirë një prezantim multimedial. Ky prezantim mund të përmbajë segmente video

⁹³ Rudvin, M. & Tomassini, E. 2008. "Migration, ideology and the interpreter-mediator: The role of the language mediator in education and medical settings in Italy", in C. Valero-Garcés & A. Martin (eds.) *Crossing Borders in Community Interpreting: Definitions and dilemmas*, Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins, pp. 245–266

⁹⁴ Bassnett, S. 2011. *Reflections On Translation*. Bristol and Buffalo and Toronto: Multilingual Matters

të tyre duke lexuar përkthimin në gjuhën e tyre, analiza mbi mënyrën se si kanë interpretuar kontekstin kulturor të poezisë, dhe përdorimi i elementeve multimedialë për të forcuar përjetimin e dëgjuesve.

Përmes kësaj përvoje, ata do të zhvillojnë aftësitë e tyre të përkthimit, kuptimin e kontekstit kulturor, si dhe aftësitë multimediale për të ndarë përvojën e tyre me audiencën;

- ✓ simulime të situatave ndërkulturore: Duke organizuar simulime të situatave të vërteta ndërkulturore, studentët përballet me sfidat reale të përkthimit dhe komunikimit në një mjedis multikulturor. Kjo mund të përfshijë shkëmbime rolesh, ku studentët përjetojnë rolet e një përkthyesi ndërkulturor në një kontekst të përcaktuar⁹⁵. Një shembull konkret nga gjuha shqipe për simulime të situatave ndërkulturore mund të jetë organizimi i një skenari shkollor ku studentët përjetojnë një situatë praktike përkthimi dhe komunikimi në një mjedis multikulturor (skenari: një klasë e studentëve shqiptarë është duke studiuar një tekst letrar të një autori grek të shekullit të njëzetë. Për të bërë eksperiencën më intensive, pedagogu mund të organizojë një simulim ku secili student përjeton rolin e një përkthyesi ndërkulturor në një kontekst të përcaktuar; Hapat e simulimit: a) zgjedhja e tekstit: studentët zgjedhin një fragment të një romanit, një poezie, apo një eseje nga autori grek i studiuar në klasë. Teksti duhet të jetë i pasur me elemente kulturore dhe të ketë sfida përkthimi, b) përkthimi i tekstit: secili student përkthen tekstin nga gjuha greke në shqipe, duke theksuar thellësinë e kontekstit dhe duke ruajtur shprehjet dhe vlerat origjinale të autorit, c) simulimi i rolit: në fund, studentët organizojnë një sesion ku secili prej tyre paraqet përkthimin e tij para klasës, duke shpjeguar vendimet e tij në përkthim dhe si kanë interpretuar elementet kulturore, d) shkëmbimi i roleve: pas paraqitjeve individuale, pedagogu mund të organizojë një shkëmbim rolesh, duke i vendosur studentët në role të ndryshme si përkthyes ndërkulturorë. Për shembull, ata mund të paraqesin përkthime të njëjta në grupe dhe pastaj të bëjnë një komentim dhe krahasim mes tyre.

Kjo strategji e simulimit të situatave ndërkulturore do të ndihmojë studentët të përjetojnë sfidat e përkthimit dhe komunikimit në një kontekst të caktuar kulturor, duke i bërë ata më të ndërgjegjshëm ndaj dallimeve gjuhësore dhe kulturore;

- ✓ analiza e teksteve multikulturore: studentët mund të zgjedhin dhe analizojnë tekste nga kultura e tyre origjinale dhe pastaj të përkthejnë

⁹⁵ Valero-Garcés, C. 2008. "Hospital interpreting practice in the classroom and the workplace", in C. Valero-Garcés & A. Martin (eds.) *Crossing Borders in Community Interpreting: Definitions and Dilemmas*, Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins, pp. 165-185

ato në gjuhën tjetër. Kjo mund të shoqërohet me diskutime të thella mbi dallimet kulturore që shfaqen në përkthim dhe mënyrat e interpretimit të tyre⁹⁶. Për të ilustruar këtë ide në kontekstin shqiptaro-grek, studentët shqiptarë mund të zgjedhin një poezi të njohur nga poezia shqiptare, për shembull, “Poema e Mjerimit” nga Migjeni. Kjo poezi ka një thellësi emocionale dhe shpreh trishtimin e autorit për gjendjen e shoqërisë së kohës së tij. Studentët mund ta analizojnë kontekstin historik dhe kulturor shqiptar në të cilin u krijua poezia dhe do të përpiqen të kuptojnë shpirtin dhe mesazhin që Migjeni dëshiron të komunikojë. Pasi të kenë analizuar poezinë në kontekstin e saj origjinal, studentët do të përkthejnë “Mjerimin” në gjuhën greke. Në këtë proces, ata do të ballafaqohen me sfidat e përkthimit të një poezie me ngjyra të thella emocionale dhe do të mundohen të transmetojnë shpirtin e asaj poezie në gjuhën e tyre të përkthyer. Pas përkthimit, do të organizohen diskutime mbi dallimet kulturore që shfaqen në përkthimin e “Mjerimit”. Studentët mund të analizojnë ndryshimet në perceptimin e trishtimit, emocioneve dhe vlerave që shpreh Migjeni në poezinë origjinale. Kjo do të sjellë përpara ndryshimet në interpretimin dhe kuptimin e mesazhit të poezisë nga një kulturë në tjetrën;

- ✓ fushata të përkthimit multimedial: përdorimi i teknologjisë dhe krijimi i projekteve multimediale përmes të cilave studentët mund të përkthejnë dhe përshtatin përmbajtje nga një kulturë në tjetrën. Kjo jo vetëm rrit aftësitë e përkthimit, por gjithashtu zhvillon aftësinë e studentëve për të komunikuar në një mjedis dixhital dhe multikulturor⁹⁷. Për shembull, në kuadër të fushatës së përkthimit multimedial, studentët nga një klasë shqiptare dhe një klasë greke mund të bashkëpunojnë në një projekt përkthimi multimedial. Ata mund të zgjedhin një poezi nga një autor shqiptar të njohur dhe ta përkthejnë atë në gjuhën greke. Pasi kanë përkthyer poezinë, ata mund të krijojnë një projekt multimedial për ta prezantuar përkthimin dhe për të shpjeguar kontekstin kulturor dhe historik të poezisë. Projekti mund të përfshijë krijimin e një videoje kur studentët paraqesin përkthimin e tyre, duke përdorur materiale të ndryshme si pamje nga vendi i autorit, informacion rreth kohës kur është shkruar poezia, dhe detaje mbi jetën dhe veprën e autorit. Gjithashtu, ata mund të përdorin elemente multimediale si muzika tradicionale shqiptare ose pamje të poezisë origjinale. Kështu, përmes kësaj fushate, studentët do të jenë në gjendje të përdorin teknologjinë dhe aftësitë e tyre përkthimi për të sjellë përpara audiencën e tyre greke një eksperiencë të pasur me

⁹⁶ House, J. 2016. *Translation As Communication Across Cultures*. London and New York: Routledge

⁹⁷ Schleiermacher, F. 1813/1992. «On the different methods of translating» στο R. Schulte και J. Biguenet (επιμ.) (1992)

kulturë dhe për të komunikuar në një mjedis dixhital dhe multikulturor. Ky projekt do të përcjellë jo vetëm mesazhin letrar, por edhe njohuritë e thella mbi kontekstin kulturor shqiptar, duke ndihmuar në shpërndarjen dhe promovimin e kulturës së tyre në një audiencë të re;

- ✓ integrimi i teksteve klasike greke dhe folklorit shqiptar: Përdorimi i teksteve klasike greke dhe folklorit shqiptar në mësim mund të jetë një mjet efektiv për të sjellë përpara nxënësit aspekte të thella të kulturave të ndryshme⁹⁸. Për të shpjeguar idenë e integritit të teksteve klasike greke dhe folklorit shqiptar në mësim, mund të shohim një shembull konkret duke krahasuar dy pasazhe, një nga klasiku grek dhe një nga folklori shqiptar: a) pasazhi nga Iliada e Homerit (teksti klasik grek), ku një grup studentësh mund të përkthejnë dhe të analizojnë një pasazh nga Iliada e Homerit, siç është episodi i Luftës së Trojës. Ata do të diskutojnë për rolin e heronjve, siç është Akili, dhe do të analizojnë vlerat dhe traditat e shoqërisë së lashtë greke, b) përralla shqiptare (folklori shqiptar), ku një grup tjetër grup studentësh mund të zgjedhë një përrallë shqiptare, si “Hija e maleve” nga Ernest Koliqi. Ata do të përkthejnë dhe do të shpjegojnë mesazhet kulturore dhe vlerat që shfaqen në këtë përrallë tradicionale shqiptare. Në përfundim, studentët do të diskutojnë dhe krahasojnë temat dhe vlerat që shfaqen në të dy tekstet. Për shembull, ata mund të krahasojnë dinamikën e heroit në Iliada me karakterin kryesor të një përralle shqiptare dhe të diskutojnë se si çdo traditë shpreh vlerat dhe identitetin kulturor të saj.

Ky shembull konkret i përdorimit të teksteve klasike greke dhe folklorit shqiptar në mësim do të ndihmojë nxënësit të kuptojnë dhe të vlerësojnë thellësinë e kulturave të ndryshme nëpërmjet pasazheve të shquara të historisë dhe folklorit.

Këto strategji ofrojnë një përjasje të pasur dhe inovative në mësimin e gjuhëve të huaja, duke përqendruar vëmendjen në formimin e aftësive të studentëve për të operuar si përkthyes ndërkulturorë në një shoqëri gjithnjë e më të globalizuar. Kombinimi i këtyre strategjive siguron një përvojë mësimore të pasur dhe të përshtatshme për botën e sotme multikulturore.

PËRFUNDIM

Në një kohë kur globalizimi po forcon lidhjet midis shoqërive dhe komunikimi ndërkulturor po bëhet jetik për zhvillimin shoqëror dhe personal, roli i pedagogut të gjuhëve të huaja si përkthyes ndërkulturor po kap një rëndësi të veçantë. Ky

⁹⁸ Παπασαλιά, Φ. & Σελλά-Μάζη, Ε. 2010. Γλωσσολογική προσέγγιση στη Θεωρία και τη Διδακτική της Μετάφρασης. Αθήνα: Παπαζήσης.

rol nuk është thjesht një përkthyes fjalësh, por një udhëheqës i aftë që shkon përtej kufijve të thjeshtë të përkthimit dhe kujdeset për të udhëzuar studentët në njohjen dhe kuptimin e kontekstit kulturor të gjuhës origjinale dhe atë të gjuhës së përkthyer.

Pedagogu i gjuhëve të huaja duhet të krijojë një mjedis mësimor inovativ dhe përfshirës, duke përdorur strategji të ndryshme për të inkurajuar zhvillimin e aftësive të studentëve në fushën e përkthimit ndërkulturor. Duke përdorur projekte të përkthimit të kulturës, simulime të situatave ndërkulturore, analizën e teksteve multikulturore dhe fushatat e përkthimit multimedial, pedagogu ndihmon studentët të zhvillojnë njohuri të thella kulturore dhe aftësi të përkthimit, duke i përgatitur ata për një shoqëri të lidhur ngushtë me realitetin multikulturor.

Roli i pedagogut të gjuhëve të huaja si përkthyes ndërkulturor kërkon jo vetëm njohuri të thella të gjuhës, por edhe një kuptim të thellë të kontekstit kulturor dhe shoqëror. Pedagogu duhet të inkurajojë respektin ndaj diversitetit kulturor dhe të krijojë një mjedis mësimor që nxit reflektimin mbi dallimet dhe ngjashmëritë kulturore. Përmes kësaj qasjeje të përgjegjshme dhe inovative, pedagogu bën një kontribut të pazëvendësueshëm në përgatitjen e një brezi të ri të studentëve për të funksionuar me sukses në një shoqëri të vazhdueshme në ndryshim dhe globalizim.

BIBLIOGRAFIA

1. Arthur, N., Stewart, J. (2001). Multicultural Counselling in the New Millennium: Introduction to the Special Theme Issue. *Canadian Journal of Counselling/ Revue canadienne de counseling*/2001, Vol. 35:1
2. Bassnett, S. 2011. *Reflections On Translation*. Bristol and Buffalo and Toronto: Multilingual Matters
3. Darling-Hammond, L. (1998). Teachers and teaching: Testing policy hypotheses from a national commission report. *Educational Researcher*, 27(1)
4. Deardorff, D. K., & Van Gaalen, A. (2012). Outcomes assessment in the internationalization of higher education. *The SAGE handbook of international higher education*
5. Garcia, M. Të Kuptuarit e Sfidave në Përkthimin Ndërkulturor. *Studime Kulturore*, 25(3), 112-130
6. Hernandez, A. (2022). "Dallimet Kulturore në Mësimin e Gjuhëve të Huaja." *Konferenca Ndërkombëtare e Pedagogjisë*, 14(1), 45-58
7. House, J. 2016. *Translation As Communication Across Cultures*. London

- and New York: Routledge
8. Jones, S. (2019). “Roli i Pedagogut në Edukimin Ndërkulturor.” *Revista Përkthyesit*, 14(2), 45-58
 9. Major, E. 2006. Secondary teachers as Cultural Mediators for Language Minority Students. *The Clearing House: A Journal of Educational Strategies, Issues and Ideas*. 80(1), 29-32
 10. Pascua, I. 2003. “Translation and Intercultural Education”, *Meta-traduction pour les enfants*, 48, pp. 276-284
 11. Pym, A. (2012) *On Translator Ethics* Trans. Heike Walker. Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins
 12. Rudvin, M. & Tomassini, E. 2008. “Migration, ideology and the interpreter-mediator: The role of the language mediator in education and medical settings in Italy”, in C. Valero-Garcés & A. Martin (eds.) *Crossing Borders in Community Interpreting: Definitions and dilemmas*, Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins, pp. 245–266
 13. Schleiermacher, F. 1813/1992. «On the different methods of translating» στο R. Schulte και J. Biguenet (επιμ.) (1992)
 14. Valero-Garcés, C. 2008. “Hospital interpreting practice in the classroom and the workplace”, in C. Valero-Garcés & A. Martin (eds.) *Crossing Borders in Community Interpreting: Definitions and Dilemmas*, Amsterdam & Philadelphia: John Benjamins, pp. 165-185
 15. Γεράλη-Ρούσου, Ελένη (2006). «Κίνητρα παρώθησης των εκπαιδευτικών», στο: Πρακτικά Συνεδρίου με θέμα: Οι Ξένες Γλώσσες στη δημόσια υποχρεωτική εκπαίδευση: δεδομένα και προοπτικές, Παιδαγωγικό Ινστιτούτο, Αθήνα 31 Μαρτίου-2 Απριλίου 2006
 16. Γκόβαρης, Χ. 2001. Εισαγωγή στην διαπολιτισμική εκπαίδευση, Ατραπός
 17. Μπατσαλιά, Φ. & Σελλά-Μάζη, Ε. 2010. Γλωσσολογική προσέγγιση στη Θεωρία και τη Διδακτική της Μετάφρασης. Αθήνα: Παπαζήσης.
 18. Μπίκος Κ. (2008). Κοινωνικές σχέσεις στην τάξη εφήβων με πολιτισμικές ιδιαιτερότητες. Στο Παπαναούμ Ζ. (επιστημονική υπεύθυνος), *Διαπολιτισμική Εκπαίδευση και Αγωγή-Οδηγός Επιμόρφωσης*. Θεσσαλονίκη: ΑΠΘ
 19. Ο διαπολιτισμικός μεταφραστής. Υπουργείο Μετανάστευσης και Ασύλου <https://migration.gov.gr/migration-policy/integration/draseis-koinonikis-entaxis-se-ethniko-epipedo/draseis-diapolitismikis-diamesolavisis/>

SOKOL ÇUNGA
ARISTOTLE UNIVERSITY OF THESSALONIKI, PHDS
(GENERAL DIRECTORATE OF ARCHIVES, TIRANA, ALBANIA)
sokolcunga@gmail.com

**WORDS, POETRY, POEMS: CULTURAL RELATIONS BETWEEN
GREECE AND ALBANIA THROUGH THE WORK OF THE ALBANIAN
WRITER LASGUSH PORADECI**

ABSTRACT

Since the 18th century, education in Greek language schools used to be the main education for the Orthodox Christians of the Southern Albania (but not only). While the 19th century school, the Zosimaia of Ioannina, was the seedbed of many Albanians who took active role into the Albanian Renaissance of the 19th century. During the 19th-beginning of the 20th century many Albanians were educated in the Greek schools of Epirus, Macedonia, and Monastir. Lasgush Poradeci (1899 – 1987) did not study in any of these schools, but the tradition was all around him: as a student at the Romanian high school in Monastir and then at the French Lyceum of Athens, as a university student in Bucharest and as a PhD student of philology in Graz.

Lasgush's work is characterized by the genuine use of the Albanian language, by the strong control of meter in poetry, but also by the multiple levels of meanings in the same text. Researchers attribute to Lasgush unique literary and language abilities, but they rarely have taken any position about the source-texts that may have influenced Lasgush. In this paper we will identify those cases when Modern Greek literature has influenced Lasgush's work. Moreover, the cases will be compared and analyzed, while trying to argue the importance of the inter-cultural and inter-lingual exchange and communication between Greece and Albania.

Keywords: *inter-cultural relations, inter-lingual relations, Albanian literature, Greek literature.*

ABSTRAKT

Që prej shek. XVIII arsimit në shkollat që përdornin gjuhën greke ishte arsimit kryesor për të krishterët ortodoksë të Shqipërisë së Jugut (por jo vetëm). Kurse shkolla e shek. XIX, Zosimea e Janinës, ishte fidanishtja e shumë shqiptarëve që luajtën rol aktiv në Rilindjen Shqiptare të shek. XIX. Gjatë shek. XIX-fillimit të shek. XX, shumë shqiptarë u shkolluan në shkollat greqisht në Epir, Maqedoni dhe Manastir. Lasgush Poradeci (1899-1987) nuk studioi në ndonjë nga këto shkolla, por traditën e kishte kudo përreth: si student në shkollën e mesme rumune në Manastir, më pas në Liceun Francez të Athinës, si student universitar në Bukuresht dhe si student doktorial për filologji në Grac.

Puna e Lasgushit karakterizohet nga përdorimi gjenial i gjuhës shqipe, nga kontrolli kompetent i metrit të poezi, por dhe nga nivelet e shumëfishta kuptimore që bart i njëjti tekst. Studiuesit i atribuojnë Lasgushit aftësi unike letrare dhe gjuhësore, por rrallë kanë marrë qëndrime rreth teksteve burimore që mund të kenë ndikuar Lasgushin. Në këtë artikull do të identifikojmë ato raste kur letërsia bashkëkohore greke ka ndikuar punën e Lasgushit. Këto raste do të krahasohen dhe analizohen, teksa rrekemi të argumentojmë rëndësinë e shkëmbimeve ndërkulturore dhe ndërgjuhësore, si dhe rëndësinë e komunikimit mes Greqisë dhe Shqipërisë.

Fjalë kyçe: *marrëdhënie ndërkulturore, marrëdhënie ndërgjuhësore, letërsi shqipe, letërsi greke.*

Since the second half of the 18th century, during the entire 19th century, the Neo-Hellenic Illuminism was an important contributor to the ideas that served as the foundation of the Albanian Renaissance and the national awakening of the Albanians. The strong connections, tempered during the Ottoman Empire, started to suffer when the Megali Idea appeared as a threat for the Southern part of Albania, while Albanians were struggling to invent and apply the principles of the national state. The years of the First World War were especially critic for these relations.

Nevertheless, cultural communication was not suspended. I will come directly to my subject: the work of Lasgush Poradeci and the influences of Greek language and literature in his case, after a brief biography of the author.

Lasgush Poradeci, the pen name of Llazar Gusho, was born in Pogradec on December 27th, 1899, and died on November 12th, 1987. His literary activity, concentrated mostly during the years 1920 – 1944, includes two books of poetry and plenty of critical papers published in different periodicals. After the WWII he worked mostly as a translator of eminent authors from German and Russian literature until his retirement.

Lasgush was educated between Monastir (nowadays Bitola), Athens, Bucharest, and Graz. In the framework of this paper, it is important to mention his 4 years stay in Athens, a time shared between studies at the Lycee Française Leonin and recovering from his lifelong lung disease at the “Sotiria” Sanatorium. (During those years he also worked for a short period of time at the Ionian Bank.) While latter, during his university and PhD studies, his ties with Greek language and philology should have been those of an academic level.

1. How can one prove the influence of Greek language and culture on the work of Lasgush? For as much as we know, Lasgush never mentioned any admiration for the Greek literature of his time. Nevertheless, during his prolonged studies it is very natural that he studied Greek language and literature, as a philology student. Thus, it is not strange to see that he is using an Albanian word according to the “Greek” way.

[...]

Ndaj hoqa rëndë-ashtu,

Gjer në greminë,

Llaftarën **që më zu**

Për dashurinë;

[...]

(“Gremina”, p. 296.)

[...]

Ah ku ‘sht ajo, ajo,

Që dashuronja,

Dhe llaftaronja, oh,

Kur t’a shikonja!

[...]

(“Kamadeva”, p. 338.)

